



RTK 1
Mentor SHALA
Drejtor
Prishtinë

Ankesa Nr. 2017/62 KPM vs RTK 1
Ref:1708/785/KPM/am

VENDIM

**Lidhur me Ankesën nr. 2017/62 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) kundër RTK 1
("Pala Përgjegjëse")**

Faktet

1. Pala Përgjegjëse është transmetues publik me seli në Prishtinë. Pala Përgjegjëse është pajisur me licencë të KPM-së me datën 28 gusht 2009. Pranimi dhe nënshkrimi i Licencës obligon të Licencuarin që të veprojë në përputhje me Ligjin e KPM-së dhe me të gjitha aktet nënligjore të miratuara nga KPM.
2. KPM ka miratuar Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM-2016/03, i cili ka hyrë në fuqi më 11 tetor 2016. Me Kodin e Etikës KKPM-2016/03 janë përcaktuar rregullat e etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në pajtim me dispozitat ligjore që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike.
3. KPM gjatë kohës së fushatës zgjedhore ka bërë monitorimin e Palës Përgjegjëse me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë me Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM-2016/03, me theks të veçantë prezencën e fëmijëve në spotet e ndryshme promovuese të partive politike.
4. KPM bazuar në monitorimet që janë bërë gjatë fushatës zgjedhore për pajtueshmërinë e Palës Përgjegjëse me Ligjin për Zgjedhjet Nr. 03/L-073 ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka transmetuar spot politik në të cilin ishin të përfshirë fëmijë. Spoti është identifikuar si spot me pagesë nga subjekti politik AAK.

Analiza Ligjore

5. Komisioni bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës ka transmetuar spot politik në të cilin ishin të përfshirë fëmijët dhe me këtë ka bërë shkelje të nenit 9, paragrafi 7, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03, i cili përcakton se:


“Nuk lejohet përdorimi dhe prezenca e fëmijëve në spotet e ndryshme promovuese të partive politike.”

Vendimi

6. Komisioni bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 9, paragrafi 7, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.
7. Komisioni bazuar në nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së sanksionon me **Vërejtje** Palën Përgjegjëse për shkelje të nenit 9, paragrafi 7, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

E drejta për Ankesë

8. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
9. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.


Adnan MEROVCI
Kryetar



10.08.2017
Datë